Kronikë

# VIDEO/ I vuri tritolin lokalit në Rrjoll të Velipojës, arrestohet 28-vjeçari! Momenti kur i maskuar tenton të hedhë lëndën plasëse

*Erison Gjeka, është arrestuar nga policia e Shkodrës pasi i vuri tritolin lokalit të marrë me qira nga Andri Daja në 30 korrik në fshatin Rrjoll në Velipojë. Policia thotë se 28-vjeçari ka vepruar në bashkëpunim me një tjetër. Siç duket nga kamerat e sigurisë, i riu i veshur me të zeza dhe më kapuç tenton të hedhë lëndën plasëse para lokalit, por më pas e hedh në taracë.*

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
13 Gusht, 10:14 | **Përditesimi: 13 Gusht, 10:35**

Share

**SHKODËR-** Erison Gjeka, është arrestuar nga policia e Shkodrës pasi i vuri tritolin lokalit të marrë me qira nga ***Andis Danaj në 30 korrik*** në fshatin Rrjoll në Velipojë. Policia thotë se 28-vjeçari ka vepruar në bashkëpunim me një tjetër. Siç duket nga kamerat e sigurisë, i riu i veshur me të zeza dhe më kapuç tenton të hedhë lëndën plasëse para lokalit, por më pas e hedh në taracë.

> *'Nga hetimet dyshohet se **Erison Gjeka**, në bashkëpunim me një shtetas tjetër, më datë 30.07.2024, në fshatin Rrjoll, kanë hedhur një sasi lënde eksplozive në tarracën e një lokali (bar dhe restorant) në pronësi të Andis Danajt, duke shkaktuar dëme materiale.'- njofton policia.*

28-vjeçari i arrestuar, rezulton me precedent të theksuar kriminal në fushat e krimeve kundër personit dhe pronës.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
**Shkodër/ Plagoset një person në aksin Postribë-Prekal! Arrestohet autori dhe sekuestrohet arma e zjarrit (EMRAT)**

Në gusht të 2020 ***Erison Gjeka*** mbeti i plagosur pasi u qëlluar me armë zjarri në lagjen 'Skënderbeg' në afërsi të ish-Fermentimit të duhanit. Gjeka mbeti i plagosur bashkë me Ndue Palin, në këmbë.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Erison Gjeka | Shkoder | velipoje | Andis Danaj

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

**Sondazhi i ditës:**
**Ngjarja në Pogradec, jeni dakord me akuzën si vrasje nga pakujdesia?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Nuk përmbushën detyrat në luftën kundër kanabisit, përjashtohen 4 efektivë policie në Pukë, mes tyre edhe ish-shefi i komisariatit Fiqiri Dani

Sokol Dema

13 Gusht, 12:17

"Logu i Bjeshkëve", malësorët ruajnë traditën! Vajzat e bukura, veshur me xhubleta performojnë në amfiteatrin natyror të Predelecit

Ergys Kavaja

12 Gusht, 16:56

Shkodër, asgjësohen 18469 bimë kanabisi, nën hetim 3 kryepleq dhe 2 specialistë pyjesh

12 Gusht, 13:19

Vodhën 140 mijë € në Shkodër, pas mashtrimit në Exchange fshiheshin 3 gjeorgjianë! Njëri kapet në Stamboll, deportohet! Dyshohet se vodhën edhe në Tiranë e Vlorë

Sokol Dema

11 Gusht, 13:27

U hodh për t'u larë në lumin Buna, mjeku i QSUT dëmtime në kokë, u përplas me gurët! Kolegët mesazh: Shërim të shpejtë

11 Gusht, 12:04

Dy aksidente me vdekje në Fier e Koplik, mjetet përplasin drejtuesit e motorëve

11 Gusht, 11:39

U hodh për t'u larë në lumin Bunë, plagoset mjeku kirurg i QSUT-së! Burime: Është në gjendje të stabilizuar

10 Gusht, 21:58

Vidhet pika e këmbimit në Shkodër! Dy të huaj mashtruan punonjësin e 'Exchange' dhe i morën paratë (VIDEO)

9 Gusht, 21:29

Velipoja plazhi më i populluar në vend! Java e parë e gushtit shënon fluksin më të lartë të sezonit

Ergys Kavaja

8 Gusht, 12:10



Mero Baze: Himara, Shkodra e dytë e Edi Ramës

Mero Baze

7 Gusht, 20:06

8 vatra aktive zjarri në të gjithë vendin, Ministria e Mbrojtjes: Nuk paraqesin rrezik për zonat e banuara

7 Gusht, 18:47

Shkodër/ Megaoperacioni 'Territor i pastër', asgjësohen 2944 bimë kanabis! Në kërkim autorët

6 Gusht, 09:42



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje